



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:226587
Datë: 17.09.2024
Numri i dokumentit: 06169211

C-IV-14-4569

Ankuesi

B M, Prishtinë
Përfaqësuar nga Av.Z Z , Prishtinë

Kundër

E paditura

Agjencia Kosovare e Privatizimit-AL për NSH “Gërmia” (ne likuidim) , Rr.“Dritan Hoxha” nr.55 Lakrishtë , Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Diellza Hoxha me 17 shtator 2024, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- 1.APROVOHET** si pjesërisht e bazuar ankesa dhe ndryshohet vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së PRN093-0564, i datës 04 qershor 2014,
- 2.OBLIGOHET** e paditura AKP ti paguaj ankuesit B M në emër të kompensimit te mjeteve të asistencës sociale, shumën prej **564.00 €** ndërsa, pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, refuzohet si e pa bazuar.
- 3.** Shumat e aprovuar si në pikën 2 të dispozitivit do të përmbushen në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 13 qershor 2014, ankuesi parashtrroi ankesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (tutje shkurt AL) nr. PRN093-0564 të datës 04 qershor 2014 me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensimin e mjeteve të asistencës sociale ndaj NSH “Gërmia” (në

Likuidim). Ankuesi pohoi se me vendimin PRN093-0564 gjendja faktike nuk është vërtetuar fare sepse deri në momentin e likuidimit të NSH “Gërmia” ankuesi ka qenë në listën e pagave dhe ka marrë edhe 20% nga shitja e aseteve të Ndërmarrjes në Likuidim. Sipas saj AL- me vendim e ka refuzuar pa të drejtë kërkesën e tij sepse, ai është lajmëruar në punë por pa fajin e tij ai është caktuar në asistencë sociale të cilat janë marrë nga mjetet e qirave të paguara nga lokalet e Gërmisë. Meqë NSH “Gërmia” nuk ka qenë duke funksionuar si ndërmarrje prodhuese, prej momentit të likuidimit punëtorët kanë kërkuar asistencën sociale të pa paguar prej vitit 01.01.2005 deri 14.08.2007 në shumë prej 1,575.00 € që do të thotë 50.00 € në muaj. Në fund ankuesja kërkon nga Dhoma e Posaçme , që të merr vendim dhe të vendos në mënyrë meritore në këtë çështje.

Ankesës ka bashkëngjitur:

- kopjen e vendimit të likuidimit PRN093-0564 datës 04.06.2014,
- kopjen e formularit kërkesës për Likuidim te datës 23 tetor .2007,
- kopjen e njoftimit për fillimin e procedurës se likuidimit
- Letër pezullimin e datës 14 gusht 2007
- kopjen e vendimit për asistence sociale nr.565 te datës 05.06.2001.
- kopjen e vendimit për asistence sociale nr.876 te datës 05.02.2003
- Listën e punëtorëve te cilët kane plotësuar kriteret për përfitim te 20%
- Listën e punëtorëve ne asistencë sociale janar –dhjetor te vitit 2005

Me 26 gusht 2024 e paditura në mbrojtjen e saj të parashtruar ndaj ankesës, pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se kërkesa e parashtruesit është refuzuar duke u bazuar në faktet dhe bazat ligjore, Neni 36.2.2 i Shtojcës së Ligjit për AKP-në, parashikon “ *elementet në vijim përbëjnë bazë të mirë dhe të mjaftueshme sipas këtij ligji për refuzimin e një kërkesë apo interesi të pretenduar të kapitalit apo pronësisë...dokumentacioni për kërkesën apo interesin e pretenduar i paraqitur nga kreditori i pretenduar mbetet jo i plotë edhe pas kërkesës nga kreditori i pretenduar për dokumentet apo dëshmi plotësuese* ”.

Më tutje e paditura thekson se ankesa e parashtrueses është e pa pranueshme. Pala kundërshtare konsideron se është e rëndësishme të theksohet se objekt i kësaj procedure gjyqësore është vetëm ligjshmëria (përputhshmëria me Ligjin 04/L-034) e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit. Në këtë kontekst, 74.2 i Ligjit 06/L-086 parashikon që ankesat e dorëzuara në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit.

Sipas AKP-së parashtruesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL-ja në marrjen e Vendimit, dhe në këtë mënyrë ka shkelur Nenin 74.2 i Ligjit 06/L-086 i cili parashikon që ankesat e dorëzuar në DHPGJS kundër vendimeve të AL-së duhet të bazohen në pretendimin se procesi i likuidimit nuk është kryer në përputhje me Ligjin 04/L-034 për Agjencinë Kosovare të Privatizimit..

Në fund të përgjigjes së saj AKP thekson se ankesa duhet refuzuar si e pa pranueshme dhe e pa bazuar dhe kërkon që të vërtetohet vendimi i AL-së në pajtim me nenin 74.4 të Ligjit Nr. 06/L-086.

Arsyetimi ligjor

Ankesa aprovohet pjesërisht si e bazuar.

Ne bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se nuk është kontestues fakti se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, por nga shkresat e lëndës gjykata vjen në përfundim se ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh, për periudhën e pretenduar . Ankuesi nuk ka ofruar dëshmi lidhur me periudhën dhe llogaritjen e asistencës sociale të pa paguar si dhe ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij.

Sa i përket periudhës së vitit 2005, ankuesi ka parashtruar gjykatës listën e punëtorëve në asistencë sociale për periudhën janar - dhjetor 2005. Në bazë të kësaj liste ankuesi figuron i renditur nën numrin 226 dhe shihet që shume neto e pa paguar për periudhën janar – dhjetor te vitit 2005 është 564.00 euro.

Vendimi PRN093-0564 i datës 04.06.2014 dhe Formulari i kërkesës, Vendimi nr. 565 i datës 05.06.2001, vendimi nr.876 i datës 05.02.2003 të dorëzuara nga ankuesi nuk mund të shërbejnë si provë e vetme për ti njohur të drejtën e pretenduar në ankesë, pa i bashkëngjitur vendimet për

asistencë sociale për tërë periudhën e pretenduar. Por që këto prova vërtetuan pjesërisht e jo në tërësi kërkesën e tij . Ankuesi për periudhën e kërkuar nuk dëshmoi se ka pas edhe ndonjë vendim. Pra Gjykata gjen se, në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensimin e mjeteve të asistencës sociale, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Andaj në bazë të të lartë cekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Taksat gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi ka paguar taksën gjyqësore me 31 korrik 2024.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Gj y q t a r e
Diellza Hoxha